

KONTRATA SOCIALE KAMËZ

RAPORT MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE

GUSHT 2019 - GUSHT 2020

PËRGATITUR NGA:
SHOQATA PËR INTEGRIMIN E ZONAVE INFORMALE

RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE TË KONTRATËS SOCIALE BASHKIA KAMËZ

PROGRAMI: POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Gusht 2019 – Gusht 2020

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim, Tiranë;
Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
Qendra Rinore Vlorës,
Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
Epoka e Re, Fier;
Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
Qendra Rinore për Progres, Kukës,
Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.

Ky Raport është Përgatitur nga Shoqata për Integrimin e Zonave Informale në kuadër të projektit POP 2019 “Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi e vetëm autorëve.

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	5
FALENDERIME	5
HYRJE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
KONTRATA SOCIALE E BASHKISË KAMËZ	8
KËSHILLI BASHKIAK DHE VEPRIMTARIA E TIJ	9
ANALIZA E GJETJEVE SIPAS KONTRATES SOCIALE	10
PRIORITET 1: ZHVILLIMI I INCENTIVAVE PËR NXITJEN E BIZNESIT DUKE REDUKTUAR TAKSAT PËR BIZNESET E REJA QË HAPEN NGA TË RINJTË ME QËLLIM KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS.	10
PRIORITET 2: KRIJIMI I LEHTËSIRAVE NË NIVELIN E TAKSAVE / TARIFAVE LOKALE PËR KATEGORITË NË NEVOJË	11
PRIORITET 3: ADRESIMI ME PRIORITET I RREGULLIMIT TË NDRIÇIMIT DHE MIRËMBAJTJES NË NJËSINË ADMINISTRATIVE PASKUQAN.	11
PRIORITET 4: KONTROLLI MË I SHPESHTË I SHËRBIMIT TË PASTRIMIT	12
PRIORITET 5: INVESTIMI NË NGRITJEN E KOPSHTJEVE DHE ÇERDHEVE TË REJA	12
PRIORITET 6: ADRESIMI ME PRIORITET DHE ZGJIDHJA E PROBLEMEVE ME KANALIZIMET NË BATHORE, PRIORITET NË LAGJET 3 DHE 4	13
PRIORITET 7: INVESTIMI DHE ADRESIMI PËR PËRMIRËSIMIN E RRUGËVE, TROTUAREVE DHE SINJALISTIKËS	13
PRIORITET 8: NGRITJA E POLITIKAVE LOKALE PËR PËRFSHIRJEN E TË RINJVE NË VENDIMMARRJE	16
PRIORITET 9: INFORMIMI I KOMUNITETIT NË LIDHJE ME SHËRBIMET E KUJDESIT SHOQËROR PËR GRUPET NË NEVOJË	16
REKOMANDIME	18
REFERENCA	19
ANEKSE	20

Shkurtime

Nj. A.	Njësi Administrative
NE	Ndihmë Ekonomike
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministratave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
Kontrata Sociale ¹	9 prioritetet kryesore të identifikuara banorët gjatë 2019

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë kësaj periudhe të pazakontë për shkak të pandemisë COVID-19 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë të rinjtë e angazhuar, Bashkinë Kamëz, si dhe Institucionet dhe Individët/ekspertët, për përgjigjen e shpejtë, cilësore brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Kamëz, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë kësaj periudhe, periudhës së vecantë të pandemisë COVID-19 gjithashtu.

Falenderojmë veçanërisht të rinjtë dhe qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë **Olof Palme International Center** dhe **NED – National Endowment for Democracy** për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

¹ <https://popnetwork.al/kontrata-sociale-me-prioritetet-kryesore-kamez/>

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "*Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)*" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin disa Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Gjatë vitit 2019, para dhe gjatë fushatës Elektorale ne jemi fokusuar tek sjellja së bashku e grupeve lokale të të rinjve në zonat urbane dhe rurale për të zgjedhur përparësitë e të rinjve dhe më pas prezantimit të përparësive të zgjedhura për kandidatët në zgjedhjet vendore. Hartimi i Kontratës Sociale bëri që të rinjtë dhe qytetarët të kenë një mjet për të mbajtur kandidatët e zgjedhur për Kryetar Bashkie dhe Këshillin e Bashkisë përgjegjës për adresim e tyre.

Ndërtimi i bashkëpunimit efektiv të partneritetit me Drejtorinë e Rinisë, punonjës rinor ofrues shërbimesh rinore dhe të rinjtë, vajza e djem nga zonat e targetuar sollën formësimin e prioritetëve të Kontratës Sociale dhe konsolidimin në 6 çështje kryesore për të lobuar dhe punuar për to.

Forumet publike me të rinj kanë adresuar çështjet e shërbimeve publike; Qeverisja e mirë lokale; zhvillimi ekonomik lokal dhe dimensionin social. Kontakti i drejtpërdrejtë me të rinjtë në shkollat e mesme nga zonat rurale dhe urbane të përfshira në proces kontribuoi me propozime konkrete si prioritetet e të rinjve dhe komuniteteve të tyre.

Forumi për deklarimin dhe nënshkrimin e Kontratës Sociale që ishte planifikuar gjatë fushatës zgjedhore për shkak të mungesës së alternativave dhe vendimeve politike nuk u organizua sic ishte parashikuar.

Forumi u organizua në 11 Nëntor 2019 me pjesëmarrjen e më shumë se 50 qzetetyrëve, të rinjve, Kryetarit të Bashkisë Kamëz dhe përfaqësuesve të Këshillit Bashkiak.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "*Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal.*" Gjatë kësaj faze të kësaj nisme POP synon që të llobojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratën Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioritetëve të kontratës sociale për periudhën gusht 2019 – gusht 2020

Kjo periudhë përfshin procesin e konsolidimit të Qeverisjes vendore, njohjen me prioritetet e Kontratës Sociale, deklarimin publik të Kontratës Sociale në një takim të hapur me aktorët kryesorë vendore si dhe monitorim të mbledhjeve të Këshillit Bashkia dhe të zbatimit të prioritetëve të kontratës sociale.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, për një periudhë të rëndësishme të vitit 2020, ka përshtatur aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit në përshtatje me protokollet e sigurisë.

Gjatë muajve Gusht 2019 - Gusht 2020 organizata kishte si qëllim:

- Të prezantonte prioritetet e Kontratës Sociale dhe procesin e hartimit të tyre;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale;
- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Gjatë muajve Mars – Qershor 2020 fokus të vecantë iu kushtua menaxhimit të situatës Covid 19, vendimarrjes së keshillit Bashkiak dhe menaxhimit të pandemisë nga Bashkia Kamëz.²

Përmbledhje Ekzekutive

Nga monitorimi i punës së Bashkisë Kamëz mbi adresimin e prioriteteve të Kontratës Sociale dolën këto gjetje:

Nga 9 prioritetet e Kontratës Sociale vetëm 1 prioritet është adresuar, 6 janë adresuar pjesërisht, ndërsa 2 nuk janë adresuar ende.

- Bashkia Kamëz ka zhvilluar incentiva për nxitjen e biznesit duke reduktuar me 50% taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës. Ndërkohë nga banorët kërkohet ngritja e një strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit.
- Bashkia Kamëz në paketën fiskale të vitit 2020³ ka miratuar ndryshime në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë duke aplikuar një ulje deri në 70%.
- Janë kryer disa investime në sistemin e ndriçimit në Nj. A. Paskuqan dhe në mirëmbajtjen e ndriçimit për rrugën "Demokracia", por banorët kërkojnë vijimin e këtyre investimeve edhe në rrugë të tjera dytësore në këtë Nj. A.
- Në Nj. A. Paskuqan, Bashkia ka kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave në 3 zona, ndërsa në Bathore ky investim është shtrirë në 3 lagje. Megjithatë investimet e kryera banorët kërkojnë shtrirjen e këtyre investimeve edhe në lagjet e tjera si dhe shtimin e frekuencës së pastrimit.

² <https://popnetwork.al/raporti-i-monitorimit-bashkia-kamez/>

³ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

- Me investim të qeverisë Shqiptare, në kuadër të programit të rindërtimit ka filluar puna për ndërtimin e 2 kopshteve; “Lidhja e Prizrenit” Paskuqan, me kapacitet 224 fëmijë, shkolla dhe kopshti “Halit Çoka” Bathore me kapacitet 200 fëmijë. Ndërkohë nga banorët kërkohet kryerja e investimeve edhe në ndërtimin e çerdheve të reja.
- Situata e problematikave me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4, mbetet ende një shqetësim për banorët. Është vetëm një investim në proces i cili shtrihet nga lagjia nr. 1 Bathore deri në lagjen Frutikulturë.
- Në Nj. A. Paskuqan kanë nisur investimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në 13 segmente dhe është investuar në mirëmbajtjen e 5 rrugëve të tjera. Nga banorët kërkohet cilësi në kryerjen e këtyre investimeve dhe shtrirja e tyre edhe në zona të tjera të Paskuqanit, kryesisht në rrugët dytësore.
- Në Bashkinë Kamëz është konstituar Këshilli Rinor mbi bazën e ligjit për rininë, i përbërë nga nxënës të 5 shkollave të mesme. Sipas takimeve me të rinjtë banorë të Kamzës atë kërkojnë që ky Këshill të jetë realisht funksional si dhe zhvillimin e politikave rinore të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për të rinjtë.
- Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet sociale bëhet nëpërmjet afishimit të në sportelet dhe ambientet e bashkisë, nëpërmjet vizitave në familje si dhe telefonatave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë në rrjetet sociale. Banorët kërkojnë përmirësimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Kontrata Sociale e Bashkisë Kamëz

Në kuadër të projektit Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, në bashkinë Kamëz, gjatë muajit prill 2019, u zhvilluan 5 forume me banorët e njësive administrative të kësaj bashkie. Forumet kishin si qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetin, si dhe identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej 5 forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, si dhe studentë, shtëpiake apo persona të grupeve të marginalizuara.

Në secilin prej forumeve të zhvilluara, qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 17 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtëpërdrejt mbi komunitetin, që kanë të bëjnë me shërbimet publike, dimensionin social, zhvillimin ekonomik vendor dhe demokracinë vendore. Për secilën nga çështjet qytetarët dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale si dhe diskutuan mbi ato problematika që përbëjnë prioritet dhe për rjedhje duhet të përfshihen në agjendën e të zgjedhurve vendorë.

Problematikat dhe rekomandimet e dala nga këto forume u përpunuan dhe në bazë të tyre u hartua një dokument me 21 prioritete të organizuara në tre grupe: Ndërhyrje prioritare; ndërhyrje disi prioritare; dhe çështje në vijueshmëri. Nga të gjitha këto prioritetet, banorët pjesëmarrës në forume veçuan si më prioritare 9 prej tyre të cilat u përfshinë në Kontratën Sociale – Kamëz.

Pëto dy dokumenta, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore iu dërguan kandidatit për Kryetar Bashkie në Kamëz, Z. Rakip Suli, me qëllim përfshirjen e tyre në platformën e tij elektorale.

Pas përfundimit të zgjedhjeve, dhe me fillimin e punës së Z. Rakip Suli në krye të Bashkisë Kamëz, Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, organizoi një forum publik me qytetarë të Kamzës. Ky takim u organizua në datë 11 Nëntor 2019 në ambientet e Këshillit Bashkiak Kamëz. Në këtë forum, pjesëmarrësit patën mundësinë për të diskutuar me Kryetarin e Bashkisë mbi prioritetet e Kontratës Sociale dhe adresimin e tyre nga ana e bashkisë. Në fund të takimit, Kryetari i Bashkisë dhe përfaqësuesi i Këshillit Bashkiak firmosën Kontratën Sociale si një angazhim për adresimin e këtyre prioritetëve gjatë mandatit të tyre 4 vjeçar në krye të bashkisë Kamëz.

Këshilli bashkiak dhe veprimtaria e tij

Këshilli Bashkiak Kamëz

Data e Konstituimit: **07.08.2019**
 Kryetar: **Znj. Merita Prenga**
 Përbërja: **41 anëtarë**
 Ndarja Gjinore: **43.9% gra, 51.1% burra**
 Numri i mbledhjeve të zhvilluara **20 mbledhje**

Këshill Bashkiak Kamëz ka 6 komisione⁴:

1. Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit.
2. Komisioni i Shëndetësisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit
3. Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blektori dhe Pronave
4. Komisioni i Urbanistikës, Zhvillimit ekonomik dhe Infrastrukturës
5. Komisioni Juridik, Rend, Konflike
6. Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale

Gjatë kësaj periudhe, SHIZI ka monitoruar mbledhjet e këshillit Bashkiak Kamëz në lidhje me vendimet të cilat prekin prioritetet e Kontratës Sociale. Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID 19, prej datës 20 Mars 2020, mbledhjet e Këshillit zhvillohen online dhe transmetohen në median sociale⁵ të Këshillit Bashkiak.

⁴ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr-26-Date-13.02.2020.pdf>

⁵ <https://www.facebook.com/keshillibashkiakkamez/>

Në mbledhjen e datës 20.12.2019 u miratua vendimi nr. 55⁶, datë 20.12.2019 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kamëz” ku u miratuan lehtësirat në nivelin e taksave / tarifave lokale për kategoritë në nevojë të cilat adresojnë prioritetin 2 të Kontratës Sociale.

Në mbledhjen e datës 11.12.2019, u miratua vendimi nr. 48⁷, datë 11.12.2019, mbi Miratimin e heqjes së tarifave për leje ndërtimi për dëmet e tërmetit datë 21.09.2019. ku u miratuan heqja e tarifave për shqyrtimin e kërkesave për leje – punimesh për shtëpitë e dëmtuara nga tërmeti i 21.09.2019.

Vendim nr. 35⁸, datë 23.10.2019 mbi Miratimin e shumës financiare prej për periudhën Nëntor 2019-Mars 2021, me fokus përmirësimin e Shërbimeve Sociale që Bashkia Kamëz ofron për personat me aftësi të kufizuar (PAK), në bazë të marrëveshjes së nënshkruar me datë 01.11.2019 mes Bashkisë Kamëz dhe Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

Analiza e gjetjeve sipas Kontrates Sociale

Ky raportim është bazuar në përgjigjet e kërkesës për informacion që SHIZI i ka dërguar Bashkisë Kamëz, në monitorimin në terren të aksioneve dhe punës së bashkisë, monitorimin e mediave (kryesisht medias sociale) si dhe në informacionet e mbledhura nga takimet me qytetarë të njësive administrative të bashkisë Kamëz.

Nga analizimi i këtyre të dhënave rezulton se Bashkia Kamëz ka adresuar prioritet si më poshtë:

Prioritet 1: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës.

Sipas përgjigjes së bashkisë në lidhje me kërkesën për informacion, Bashkia Kamëz raporton se në paketën fiskale të Bashkisë Kamëz⁹ të miratuar në VKB 55, datë 20.12.2019, janë bërë ulje në tarifa, kryesisht tarifë pastrimi për subjektet në kategorinë: tregti, ku përfshihen: bulmet, fruta perime, ushqimore etj. Lehtësim tjetër është në kategorinë shërbime, ku përfshihen institucionet jo publike si: shkolla, kopshte, çerdhe si dhe në kategorinë e profesioneve të lira, ku përfshihen: avokat, noter, stomatolog etj.

Ndërkohë për kategoritë: kryefamiljare femër dhe të rinj nga mosha 18-25, të cilët hapin një biznes të ri, për 3 muajt e parë të hapjes së biznesit do të paguajnë 50% të të gjitha tarifave të Bashkisë Kamëz.

⁶ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

⁷ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-48-Dt-11.12.019.pdf>

⁸ <https://www.vendime.al/vendim-i-keshillit-bashkiak-kamez-nr-35-date-23-10-2019/>

⁹ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

Sipas të dhënave të marra nga Bashkia Kamëz, ka pasur një rritje të numrit të subjekteve të reja, të cilat operojnë në territorin e Bashkisë Kamëz. Për periudhën janar - korrik 2020 janë regjistruar 185 subjekte të reja.

Ndërkohë nga përgjigjet e marra prej banorëve kërkohet krijimi i incentivave të tjera për nxitjen e bizneseve nga të rinjtë siç mund të jenë inkubatorët e biznesit etj, të cilat rrisin aftësitë dhe mundësitë e të rinjve për zhvillimin e nismave dhe krijojnë premisa për hapjen e bizneseve prej tyre. Ata gjithashtu kërkojnë ngritjen e një strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit. Të rinjtë shprehën se ka nevojë për programe të cilat nxisin punësimin si p.sh. praktika profesionale pranë administratës etj.

Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, rezultojnë se *prioriteti 1* i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar pjesërisht**; me reduktimin e tarifave lokale për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë.

Prioritet 2: Krijimi i lehtësirave në nivelin e taksave / tarifave lokale për kategoritë në nevojë Bashkia Kamëz në paketën fiskale të vitit 2020¹⁰ ka miratuar ndryshime në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë. Përkatesisht për kategoritë: Invalidët e punës, të verbrit, para-tetra plegjikët, kryefamiljaret gra me mbi dy fëmijë dhe të paaftët e vetmuar paguajnë 30% të paketës familjare nga 6000 (që ka qenë në vitin 2019) në 1800 lek (në vitin 2020). Ndërkohë për pensionistët nga 6000 (që ka qenë në vitin 2019) në 1200 lek (në vitin 2020).

Ndërkohë që prej shtatorit të vitit 2019, një kategori në nevojë janë edhe familjet të cilat kanë humbur shtëpitë prej tërmetit. Për këtë kategori, në paketën fiskale të vitit 2020, është miratuar heqja e tarifave bashkiake për familjet e prekura nga tërmeti i nëntorit, heqja e tarifës prej 0.7% të investimit për legalizimet për objektet e banimit.

Pavarësisht lehtësive të krijuara në paketën fiskale të vitit 2020 nga Bashkia, banorët kërkojnë të marrin shërbime cilësore nga bashkia mbi taksat që ata paguajnë.

Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, rezultojnë se *prioriteti 2* i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar**; me reduktimin e tarifave lokale për kategoritë në nevojë.

Prioritet 3: Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe mirëmbajtjes në Njësinë Administrative Paskuqan.

Sipas monitorimit në terren dhe përgjigjes së marrë nga Bashkia, janë kryer disa investime në sistemin e ndriçimit në Nj. A. Paskuqan, përkatesisht në rrugët: “Themistokli Germenji”, “Babrru Shpat”, Rruga “Nënë Tereza”, Gjithashtu janë kryer investime për mirëmbajtjen e ndriçimit për rrugën “Demokracia”, Paskuqan.

¹⁰ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

Ndërkohë sipas qytetarëve kërkohet vijimi i këtyre investimeve edhe në rrugë të tjera në Paskuqan, të cilat kanë mungesë të sistemit të ndriçimit, gjë e cila bëhet problematike për sigurinë e qytetarëve. Gjithashtu banorët shprehen se kërkojnë mirëmbajtjen e herë pas herë të sistemit të ndriçimit në rrugët ku ofrohet shërbimi.

Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, rezultojnë se **prioriteti 3** i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar pjesërisht**; dhe ka nevojë të vijohet me investimet e nisura.

Prioritet 4: Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të Pastrimit në Nj. A. Paskuqan, në të dy lagjet, shtimi i numrit të koshave në Bathore dhe Paskuqan si dhe shtimi i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit në të gjithë Bashkinë Kamëz

Në Nj. A. Paskuqan, Bashkia ka kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave në zonat: Kodër e Kuqe, Babrru Qendër dhe Paskuqan 2. Ndërkohë në Bathore janë kryer investime për shtimin e numrit të koshave të mbeturinave dhe shtimit të frekuencës së grumbullimit të tyre në zonat: Lagje 1 Bathore, Lagje 5 Bathore, Lagje 6 Bathore.

Pavarësisht këtyre investimeve, banorët shprehen se ka nevojë ende për përmirësim shërbimi i pastrimit. Ata shprehen se nevojitet shtimi i koshave të mbeturinave dhe i vendgrumbullimeve edhe në lagje të tjera. Banorët shprehen se ka nevojë për shtimin e shërbimit të pastrimit të ambjenteve publike, si dhe duhet shtuar frekuenca e këtij shërbimi.

Sipas monitorimit të kryer deri në gusht 2020, prioriteti 4 rezultojnë **i adresuar pjesërisht**, dhe ka nevojë të vijohet me investimet e nisura në shtimin e koshave të mbeturinave dhe përmirësimi i sistemit të pastrimit.

Prioritet 5: Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Nj. A. Bathore dhe Paskuqan si dhe largimi i kopshteve nga ambientet e shkollave.

Në bashkinë Kamëz ka nisur puna për ndërtimin e 3 kopshteve, ku 2 prej tyre mbulojnë Paskuqanin dhe Bathoren. Me investim të qeverisë Shqiptare¹¹, në kuadër të programit të rindërtimit ka filluar puna për ndërtimin e kopshtit “Niko Hoxha” Valias me kapacitet 200 fëmijë, “Lidhja e Prizrenit” Paskuqan, me kapacitet 224 fëmijë, shkolla dhe kopshti “Halit Çoka” Bathore me kapacitet 200 fëmijë. Gjithashtu parashikohen të ndërtohen 1 çerdhe e re, 1 kopsht tjetër i ri dhe do rikonstruktohen 5 kopshte ekzistuese.

¹¹ Burimi i Financimit: Fondi i Rindërtimit në Buxhetin e Shtetit miratuar me Vendimin Nr. 212, datë 11.03.2020 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore”



"Lidhja e Prizrenit" Paskuqan



"Halit Çoka" Bathore

Nga përgjigjet e marra prej banorëve, ndërtimi i këtyre kopshteve të reja ndikon në plotësimin e nevojave të komunitetit të atyre zonave, por ka nevojë që të këto investime të replikohen edhe në lagje të tjera të Paskuqanit dhe Bathores për të plotësuar nevojat e të gjithë komunitetit, duke qenë se këto dy zona kanë nevojë për kopshte dhe çerdhe shtetërore.

Me këto investime shtohen kapacitetet për mbulimin e nevojës së familjeve për kopshte në Paskuqan dhe Bathore. Në bazë të raportimeve të bashkisë dhe përgjigjeve që kemi marrë nga qytetarët, rezultojnë se *prioriteti 5* i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar pjesërisht**; ka nevojë të vijohen investimet edhe për çerdhe të reja.

Prioritet 6: Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4

Nga monitorimi i punës së bashkisë Kamëz raportohet se për përmirësimin e sistemit të kanalizimeve në Bathore, është vetëm një investim në proces i cili shtrihet nga lagjia nr. 1 Bathore deri në lagjen Frutikulturë. Në këtë investim përfitojnë afërsisht 100 familje. Ndërkohë të gjitha lagjet e Bathores marrin furnizim me ujë 2 orë në ditë duke përjashtuar lagjen 4, e cila merr 2 orë në 2 ditë. Uji është i pijshëm dhe i sigurtë për t'u përdorur.

Nga takimet me banorët në Bathore, raportohet se furnizimi me ujë dhe sistemi i kanalizimeve është ende problem në këtë zonë. Ka nevojë të kryen investime për sistemimin e tubacioneve të ujrave të zeza si dhe përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm. Gjithashtu kërkohet shtimi i orareve të furnizimit me ujë.

Prioriteti 6 i Kontratës Sociale është **ende i pa adresuar**.

Prioritet 7: Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Nj. A. Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore

Sipas përgjigjes së marrë nga Bashkia, kanë nisur investimet në përmirësimin e infrastrukturës rrugore¹² në Nj. A. Paskuqan, përkatësisht:

Nr.	Investimi	Gjatësia (m)	Gjerësia (m)	Vendi ku ndodhet
1	Rruga "Abaz Ermenji"	540	7	Paskuqan 2, Vresht
2	Rruga "Aleksandri i Madh" + Rruga "Ali Kercyra" + Rruga "Azem Galica"	1,013	7 dhe 9	Paskuqan 2 Vresht, Liqeni Paskuqanit
3	Rruga "Arben Brozi", zgjatimi në të djathtë i rrugës mbi kolektor, 7. Rruga "Dede Macaj", zgjatimi i rruges mbi kolektorin kryesor,	560	7	Paskuqan 2, Fushë
4	Rruga "Isuf Xhelili"	313	8	Paskuqan 2, kodër
5	Rruga "Hoxha Tasim"	930	7	Paskuqan 1
6	Rruga "Ibrahim Rugova"	1,173	9	Paskuqan 1
7	Rruga "Konferenca e Mukjes" zgjatimi i investimit ekzistues	1,800	10.0	Babrru Kodër e Kuqe
8	Rruga "Sali Murat Vranishti"	930	7	Babrru Kodër
9	Rruga "Zigur Lelo" + Rruga "Themistokli Germenji" + Rruga "Zef Serembe"	555	7	Babrru Shpat
10	Rruga "Kaci"	390	7	Babrru i Vjetër
11	Rruga "Veli Dedi" + "Xhorxh Martini"	828	7	Babrru Fushë Kërçik
12	Rruga "Prengaj",	880	7	Babrru Fushë Kërçik
13	Rruga "Hasan Zylfia",	422	9	Babrru i Vjetër

¹² https://kamza.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/buxheti_2020.pdf




rr. "Mithat Frashëri"

Investime nga Bashkia Kamëz për përmirësimin e cilësisë së rrugëve në Nj. A. Paskuqan janë kryer në rrugët:

- Rruga Demokracia
- Rruga Drini
- Rruga Abdyl Elmazi
- Rruga Besim Çera
- Rruga Azem Hajdari

Investimet në këto rrugë përmajnë përmirësimin e sinjalistikës rrugore, rregulimin e troturave, ndriçimi etj.



Përmirësimi i sinjalistikës rr. "Demokracia", Paskuqan

Përfundimi i këtyre investimeve adreson prioritetin nr. 7 të Kontratës Sociale në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës rrugore në N. A. Paskuqan.

Ndërkohë nga banorët kërkohet cilësi në kryerjen e këtyre investimeve dhe shtrirja e tyre edhe në zona të tjera të Paskuqanit, kryesisht në rrugët dytësore. Gjithashtu banorët shprehin shqetësimin e tyre në lidhje me sinjalistikën rrugore, e cila do çojë në rritjen e sigurisë në rrugë. Banorët kërkojnë që rrugët (aty ku është e mundur) të kenë troturare sipas standarteve, ndriçim, si dhe sinjalistikë rrugore.

Nga monitorimi i deri tanishëm rezulton se *prioriteti 7* i Kontratës Sociale Kamëz është **adresuar pjesërisht**; ka nevojë të vijohen investimet.

Prioritet 8: Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak

Sipas përgjigjes së marrë nga Bashkia, në bashkëpunim me USAID është konstituar Këshilli Rinor mbi bazën e ligjit për rininë. Për ngritjen e këtij këshilli u përzgjedhën nga 6 nxënës nga 5 gjimnaze të Kamzës, me të cilët janë zhvilluar disa trajnime në lidhje me tema të ndryshme për rritjen e kapaciteteve të tyre.

Sipas takimeve me të rinjtë banorë të Kamzës atë kërkojnë që ky këshill të jetë realisht funksional dhe të përçojë zërin e tyre në Këshill. Ndërkohë ata kërkojnë edhe zhvillimin e politikave rinore që kanë të bëjnë me arsimin, punësimin, pjesëmarrjen në vendimmarrje, kulturën, çështjet sociale etj.

Nga monitorimi dhe raportimi i të rinjve ky prioritet është **adresuar pjesërisht**, por ka nevojë për zhvillimin e politikave rinore të qëndrueshme dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për të rinjtë.

Prioritet 9: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësi Administrative

Bashkia Kamëz nuk disponon qendra sociale që t'i ketë nën administrimin e vet, por ekzistojnë disa shërbime që ofrohen nga institucione apo organizata lokale¹³. Aktualisht nuk është ngritur asnjë qendër komunitare për kategoritë në nevojë, por është planifikuar në planin Social Vendor për ngritjen e shërbimeve komunitare dhe parashoqërore për fëmijët dhe të rinjtë. Gjithashtu është plotësuar formulari i aplikimit për Fondin Social Buxhetor.

Bashkia Kamëz si dhe njësi e Paskuqanit ofron këto shërbime për shtresat në nevojë:

- Trajton me ndihme ekonomike familjet në nevojë .
- Identifikon familjet e varfra dhe i orienton ato për aplikim .
- Orienton të gjithë personat në moshë punë që të regjistrohen pranë Zyrës së Punës.
- Trajtimin me paketa ushqimore, shërbime shëndetësore falas në klinika private (kur na ofrohen mundësi nga klinikat).
- Trajtimin e familjeve (jo përfituese në ndihmë) që janë shumë të varfra, me të ardhurat e Bashkisë.

¹³ Qendra polivalente e të moshuarve ku marrin shërbimin ditor rreth 24 të moshuar të cilët janë kryesisht nga Kamza; Qendra kombëtare e Dhunës ku strehohen dhe marrin shërbim gratë e dhunuara nga gjithë vendi; Organizata Caritas e cila funksionon në zonën e Paskuqanit ku strehohen dhe trajtohen persona kryesisht të komunitetit rom dhe egjiptjan; Organizata Global Care e cila vepron në zonën e Bathores ku marrin shërbim edhe persona me aftësi të kufizuara etj; Organizata Word-Vision e cila ka një fushë mjaft të gjerë veprimi në Kamëz; Qatar e cila ndihmon vazhdimisht me paketa ushqimore zonën e Kamzës. etj

- Lehtësimin nga taksat vendore të familjeve në nevojë që plotësojnë standartet sipas VKB.

Informimi i komunitetit bëhet nëpërmjet afishimit të shërbimeve në sportelet dhe ambientet e bashkisë, nëpërmjet vizitave në familje si dhe telefonatave dhe nëpërmjet faqes zyrtare të Bashkisë në rrjetet sociale. Ndërkohë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka hapur Zyrën e Punës në Kamëz, qytetarët mund të marrin informacione dhe këshillim, udhëzime për punësim, pjesëmarrje në trajnime, shërbime të tjera ndërmjetësimi etj!

Banorët shprehën se nuk kanë dijeni nëse bashkia ka shërbime sociale të ngritura për individë në nevojë për shërbime, të tilla si shërbim në familje për persona me aftësi të kufizuara ose të moshuar, qendra komunitare për familjen dhe fëmijën, qendra ditore për persona me aftësi të kufizuara, për të moshuar. Nga takimet, banorët kërkojnë përmirësimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Legjenda e adresimit të prioritetëve

Prioritet 1: Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës.

Adresuar pjesërisht

Prioritet 2: Krijimi i lehtësirave në nivelin e taksave / tarifave lokale për kategoritë në nevojë

Adresuar

Prioritet 3: Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe mirëmbajtjes në Njësine Administrative Paskuqan.

Adresuar pjesërisht

Prioritet 4: Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të Pastrimit në Njësine Administrative Paskuqan, në të dy lagjet, shtimi i numrit të koshave në Bathore dhe Paskuqan si dhe shtimi i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit në të gjithë Bashkinë Kamëz

Adresuar pjesërisht

Prioritet 5: Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Njësine Administrative Bathore dhe Paskuqan si dhe largimi i kopshteve nga ambientet e shkollave.

Adresuar pjesërisht

Prioritet 6: Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4

Nuk është adresuar

Prioritet 7: Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Njësine Administrative Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore

Adresuar pjesërisht

Prioritet 8: Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak

Adresuar pjesërisht

Prioritet 9: Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësive Administrative

Nuk është adresuar

Rekomandime

- Krijimi i incentivave për nxitjen e bizneseve nga të rinjtë siç mund të jenë inkubatorët e biznesit etj, të cilat rrisin aftësitë dhe mundësitë e të rinjve për zhvillimin e nismave dhe krijojnë premisa për hapjen e bizneseve prej tyre.
- Ngritja e një strategjie për nxitjen e biznesit dhe për pasojë nxitjen e punësimit.
- Mirëmbajtja e sistemit të ndriçimit aktual dhe vijimi i investimeve në sistemin e ndriçimit edhe në rrugë të tjera në Paskuqan.
- Vijimi i investimeve për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve të reja (jo vetëm rindërtimi i atyre aktualë) për përmbushjen e kërkesës së banorëve të Njesisë Administrative Paskuqan dhe Bathore.
- Kryerja me cilësi investimeve në infrastrukturën rrugore duke pajisur rrugët me të gjitha elementet e saj duke përfshirë edhe sinjalistikën rrugore, e cila do çojë në rritjen e sigurisë në rrugë.
- Zhvillimi i politikave rinore që kanë të bëjnë me arsimin, punësimin, pjesëmarrjen në vendimarrje, kulturën, çështjet sociale etj. dhe krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për të rinjtë në Kamëz.
- Përmirësimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Referenca

Faqja web e Bashkisë Kamëz <https://kamza.gov.al/>

Buxheti i vitit 2020, Bashkia Kamëz <https://kamza.gov.al/viti-2020/>

Buxheti i vitit 2019, Bashkia Kamëz <https://kamza.gov.al/viti-2019/>

Paketa fiskale 2020 <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2020/05/Vendim-Nr.-55.-Date-20.12.2019.pdf>

Faqja në media sociale e bashkisë Kamëz <https://www.facebook.com/Bashkia-Kamez-108419860536646/>

Faqja në media sociale e Këshillit Bashkiak
<https://www.facebook.com/keshillibashkiakkamez/>

KONTRATA SOCIALE

PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA KAMËZ 11.11.2019

Prioritet 1:

Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit duke reduktuar taksat për bizneset e reja që hapen nga të rinjtë me qëllim krijimin e vendeve të reja të punës.

Prioritet 2:

Krijimi i lehtësive në nivelin e taksave/tarifave lokale për kategoritë në nevojë.

Prioritet 3:

Adresimi me prioritet i rregullimit të ndriçimit dhe i mirëmbajtjes në Njësinë Administrative Paskuqan, sidomos në Lagjet Paskuqan 1 dhe 2.

Prioritet 4:

Kontrolli më i shpeshtë i shërbimit të pastrimit në Njësinë Administrative Paskuqan, në të dy lagjet, shtimi i numrit të koshave në Njësinë Administrative Bathore dhe Paskuqan si dhe shtimi i frekuencës së mbledhjes nga makinat e grumbullimit në të gjithë bashkinë Kamëz.

Prioritet 5:

Investimi në ngritjen e kopshteve dhe çerdheve të reja në Njësinë Administrative Bathore dhe Paskuqan si dhe largimi i kopshteve nga ambientet e shkollave: "Vëllazërimi", "Azem Hajdari" dhe "Isa Boletini".

Prioritet 6:

Adresimi me prioritet dhe zgjidhja e problemeve me kanalizimet në Njësinë Administrative Bathore, prioritet në lagjet 3 dhe 4.

Prioritet 7:

Investimi dhe adresimi për përmirësimin e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistikës në Njësinë Administrative Paskuqan me një fokus të veçantë në rrugët e brendshme dhe dytësore.

Prioritet 8:

Ngritja e politikave lokale për përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje. Ngritja e Këshillit Rinor pranë Këshillit Bashkiak.

Prioritet 9:

Informimi i komunitetit në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror për grupet në nevojë. Përmirësimi i shërbimeve sociale pranë Njësisë Administrative.

Shoqata për Integrimin e Zonave Informale

Greta Kokalari
Greta Kokalari

Kryetari i Këshillit Bashkiak

P/Hysen Koldashi
P/Hysen Koldashi

Kryetar i Bashkisë Kamëz

Rakip Suli
Rakip Suli